

LAURA SMAQI

**MBI PUNIMIN
PËR NJË HISTORI TË KRAHASUAR TË LETËRSISË SHQIPE
TË PROF. DR. DHURATA SHEHRIT
DHE PROF. DR. PERSIDA ASLLANIT**

Për një kohë të gjatë në mjedisin shkencor është diskutuar mbi mënyrën se si duhet shkruar historia apo një histori e letërsisë shqipe në gjendjen e sotme të dijës mbi letërsinë, në koherencë me frymën bashkëkohore. Gjatë rreth dy dhjetëvjeçarëve kanë mbizotëruar kontribute pa fund në konferenca të organizuara me një tematikë të tillë, të finalizuara dhe me botime aktesh, pa llogaritur kontributet me të njëjtën temë por, brenda konferencave me tematika të përgjithshme. Ndërkohë që është folur aq shumë për mënyrën se si duhet shkruar historia e letërsisë, studimet konkrete që venë në qendër të hulumtimit këto parime, për fat të keq kanë qenë dhe janë shumë më të pakta. Për këtë arsye botimet në fushë të historisë së letërsisë shqipe, gjithmonë janë jo vetëm të mirëpritura si për mjedisin shkencor, akademik, studentor e më gjerë, por në përrime të kësaj natyre, marrin dhe konotacionin entuziazmes të një kremtimi apo takimi të gëzueshëm.

Punimi “Për një histori të krahasuar të letërsisë shqipe” shkruar nga Dhurata Shehri e Persida Asllani, Albas 2021, përveçse tregon një mënyrë se si mund të shkruhet një histori e letërsisë shqipe, njëherësh, siç e vënë në dukje vetë autorët në nisje të tij, synon të jetë një skicë me disa nga linjat kryesore për hartimin e një historie të krahasuar të letërsisë shqipe. Ai konsiderohet si një zanafillë e një pune shumë më të gjerë dhe të thellë hulumtuese, që do të përfshinte të gjitha fazat e zhvillimit të letërsisë shqipe në marrëdhënie me letërsinë botërore, si një nisje kontributesh apo veprash të mëpasshme studimore. Është vërtet e nevojshme që letërsia shqipe të shihet e lidhur e në marrëdhënie dinamike e të vazhdueshme me lëvizje, shkolla, autorë e vepra të letërsisë botërore, të cilat e bëjnë njëherazi atë pjesë të zhvillimeve letrare botërore, por edhe ndihmojnë në përcaktimin e origjinalitetit të saj jo më përmes vështrimit izolacionist, të ngushtë, por përmes vështrimit përfshirës që, falë komunikimit të vazhdueshëm me letërsi të tjera modelon poetika, zhanre, stile dhe figuracion, duke krijuar origjinalitet jo më nga veçimi, por nga rikrijimi.

Studimi është konceptuar si një ndërthurje e trajtimit të aspekteve teorike me zhvillimin historik të letërsisë shqipe dhe të studimeve mbi të, me

përqendrimin në një varg *casus*-esh, rastesh ku ato aspekte që trajtohen teorikisht, shihen në autorë të periudhave të ndryshme të letërsisë shqipe, e veçanërisht në mënyrën sesi janë trajtuar në historiografinë e letërsisë shqipe. Niset me çështjen *Përthyerjet e letërsisë botërore, formantja e brendshme e letërsisë shqipe (Dukuri, nocione, paradigma)*, për t'u ndalur më gjerësisht në Kapitullin e dytë *Mbi mundësinë e një shqyrtimi historiografik krahasues*. Në këtë kapitull shihet *Prirja për të hetuar kombëtarën në historitë e letërsisë shqipe*, duke u ndalur në një varg veprash të rëndësishme me karakter historiografik, *Specifikat e zhvillimit historik të letërsisë shqipe, Premisat teoriko-kritike e ideologjike të historive të letërsisë shqipe*, dhe një vend i veçantë i lihet njërit prej autorëve jo vetëm të rëndësishëm si krijues, por që fushën e historishkrimit vendosi piketa të rëndësishme orientuese jo thjesht përsa i takon historisë së letërsisë shqipe, por dhe një historie të krahasuar të saj. Në këtë kapitull nisin trajtimet e disa rasteve specifike të autorëve brenda historisë së letërsisë shqipe, të cilat do të vijojnë dhe në kapitullin pasardhës *Dinamika të përthyerjeve dhe rrezatimeve në letërsinë shqipe*. *Casuset* shihen brenda *Dinamikave të modernes në diakroni*, në *Dinamika të përthyerjes në realizmin socialist* dhe në *Dinamika të kritikës në rrjedhë historike*. Duke pasur parasysh qasjen krahasuese, një nënçështje vë në dukje dhe shfaqje të *Dinamikave receptive të përkthimit*. Natyrisht që nuk bëhet fjalë për qasje shtruese, por për shembuj orientues të cilët shërbejnë për të tërhequr vëmendjen dhe për të shtuar studimet mbi këto çështje.

Nëse ndalemi në aspekte teorike që qëndrojnë në bazë të punimit, vëmë re se nocioni i parë që do të jetë orientues dhe do të përcaktojë këndin e vështrimit, është ai i përthyerjes, i cili ndër të tjera ndihmon të kuptohet se si autorët shqiptarë u janë drejtuar letërsive të tjera, për të marrë prej tyre në mënyrë të përzgjedhur, atë çfarë i mungonte traditës. Në një shkallë më të përpunuar ajo që merret nga letërsia të tjera nuk është imitim apo përshtatje e thjeshtë, por rikrijim sipas nevojave të letërsisë shqipe, sipas aftësive të autorëve shqiptarë, duke mundësuar që bashkëveprimi i elementeve të përthithura me traditën dhe talentin e shkrimtarit të rinovojnë krejt sistemin e letërsisë shqipe. Në shkallën më të lartë, risitë që vijnë si pasojë e “përthyerjes”, nga elementë autorësh të veçantë, kthehen në tipare mbizotëruese të krejt sistemit, në pritje të zhvillimeve që do të sjellin risi të tjera.

Në qoftë se nocioni i përthyerjes orienton qasjen studimore, teoria sistemore e Zoharit do të vihet në qendër përsa i takon trajtimit të letërsisë si polisistem të përbërë prej sistemesh të ndryshme. Ajo që paraqet veçanërisht interes është letërsia e përkthyer që funksionon jo vetëm si sistem më vete, por që ndërvepron me sistemet e tjera dhe luan rol mjaft të rëndësishëm në proceset që modelojnë qendrën apo pozicionin më me peshë të polisistemit. Duke qenë se në rrjedhën e zhvillimit të letërsisë së një vendi, aq më shumë si Shqipëria dallimi mes shkrimeve origjinale dhe atyre të përkthyer mund të mos jetë

aspak i qartë, siç është rasti i letërsisë “filobiblike”, rrezatimi i veprave të përkthyer është i tillë sa roli brenda mjedisit dhe procesit letrar të zhvillimit të letërsisë shqipe nuk mund të konsiderohet aspak si i parëndësishëm, përkundrazi. Duke qenë të vetëdijshëm për këtë rol, vetë autorët shqiptarë kanë kontribuar me përkthimet e tyre. Kujtojmë Nolin, Koliqin, Kutelin, Shantonë e më pas Tufën, Çollakun, Çoçolin, Teferiçin.

Një tjetër koncept mjaft i rëndësishëm është ai i rishkrimit, i studiuesit të njohur belg Andre Lefevere kuptuar si tërësi e proceseve përkthimore, me karakter antologjik, historiografik, kritik, redaktues etj., të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në receptimin dhe kanonizimin e veprave të letërsisë. Gjatë këtyre proceseve është theksuar, anashkaluar ose deformuar përthyerja e poetikave të letërsisë botërore në letërsinë shqipe, e gjitha kjo në funksion të formimit të shijes së lexuesit shqiptar. Mjafton të kujtojmë si tekstet ashtu dhe antologjitë shkollore të para viteve '90, të cilat krahas interpretimit ideologjik jepnin një vizion jashtëzakonisht të cunguar e si të tillë aspak objektiv të zhvillimeve letrare (jo vetëm shqiptare, ku ishin përjashtuar autorë ndër më të rëndësishmit të letërsisë shqipe, por edhe më shumë të letërsisë botërore). Me shumë të drejtë përmendet përvoja noline në letrat shqipe. Noli e rishkruan letërsinë botërore përmes shqipërimit të tij, por njëkohësisht edhe përmes interpretimit kritik të introduktave, të cilat shkojnë drejt një leximi sa personal, aq dhe ideologjik. Po përmend introduktat e Nolit, por e gjithë letërsia botërore që do të përkthehet në gjysmën e dytë të shekullit XX do të shoqërohet me tekstin prefativ ose parathëniet, të cilat me synimin për të orientuar lexuesin, deformojnë tekstin origjinal dhe e drejtojnë atë në një lexim ideologjik. Përmes shkëmbimit të teksteve, siç ve në dukje Lefevere përmes zërit të autoreve të punimit dhe siç dëshmohet në interpretimet apo edhe në “casuset” që ato kanë sjellë, kulturat dalin nga qerthulli i tyre i ngushtë, “mbrohen nga provincializmi duke mbledhur tinguj të rinj dhe të panjohur”.

Në panoramën që autorët bëjnë përsa u takon figurave më qendrore, të cilët kanë vënë në qendër të punimeve të tyre studimin krahasimtar, si një qasje mjaft të rëndësishme në shërbim të historive të letërsive dhe kulturave kombëtare, panoramë që nis me Van Tieghemin, e më pas me Lotmanin, sigurisht që ndalesa kryesore që shërben edhe si pikë referimi për studimet e aplikuara krahasimtare do të jetë Zheneti me dukuritë e intertekstualitetit e me përkufizimet e tij të intertekstit. Natyrisht janë hedhur piketat përmes shembujve, të cilat sigurisht do të vijnë me analiza të thelluara të pranisë së këtyre dukurive në vepra të autorëve të letërsisë shqipe. E rëndësishme është ftesa që i bëhet mjedisit akademik për ta thelluar këtë qasje krahasimtare. Gjithkush, e ndjen veten të ftuar që të japë kontributin shkencor në këtë aspekt, dhe ky është një ndër aspektet më të rëndësishme që gjeneron ky punim. Me këtë rast, shpreh bindjen se ai do të jetë gjenerues i diskutimeve, i debateve, dhe i veprave që do ta shoqërojnë.

